



REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep. DPK/DPKI	Nr. Prot. Br. Prot. 03-02/3229 Prot No.
Nr. i faq. Broj stranica 02 Nr. pages	Data Datum 22-09-2016 Date
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.09.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2967/16 për z. Enver Haliti – Drejtor në Komunën e Ferizajt, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për konflikt interesi, meqense z. Haliti tashmë nuk ushtron asnjë funksion si zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2967-16, për Zyrtarin e lartë, z. Enver Haliti – Drejtor në Komunën e Ferizajt, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është nis për tu trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Ndërkohë që ka rezultuar se z. Haliti tashmë nuk ushtron asnjë funksion publik (AKK-03/4509/16), dhe rasti si i tillë mbyllet.

III. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Hasan Preteni /

